



VENDIM

Nr.118, datë 21.07.2016

MBI

ANKIMIN ADMINISTRATIV TË OSHEE SH.A NDAJ VENDIMIT NR. 103, DATË 23.06.2016, “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 16 pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimine Bordit të ERE nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.07.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi kërkesen e shoqërisë OSHEE sh.a për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE nr. 103, datë 23.06.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

Konstatoi se:

- Pretendimi i OSHEE sh.a. se materiali nuk është sjelle në formën e një materiali të plotë në gjuhën zyrtare shqipe , nuk përbën shkak për rishikim të vendimit pasi OSHEE ka marrë dijëni mbi të dhe ka përcjellë edhe komentet e qëndrimin e saj mbi draftin nëpërmjet shkresës 131/1, datë 22.02.2016
- Pretendimi i OSHEE sh.a. se drafti i miratuar nuk është ai për të cilin ka filluar procedurat ERE nuk përbën shkak për të rishikuar vendimmarrjen e Bordit pasi drafti i miratuar është drafti i përmirësuar e i plotësuar me komentet e palëve në përputhje të plotë me parashikimet e legjislacionit në fuqi të sektorit të energjisë elektrike.

- Pretendimi i OSHEE sh.a. se ERE duhet të miratojë draftin e propozuar nga i licencuari, nuk përbën shkak të ligjshëm për të rishikuar këtë vendimmarrje pasi ERE, ka autoritetin për të ushtruar të drejtat por edhe detyrat që i janë ngarkuar me ligj për të “rregulluar” sektorin e energjisë elektrike.
- Ne analize të informacionit të percjelle në ankimin e OSHEE sh.a rezulton se nuk është depozituar asnjë prove e re që ta çojë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga Vendimi nr.103 date 23.06.2016.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rrëzojë kërkesën e OSHEE sh.a për rishikim e vendimit nr. 103, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.